

# CALL FOR PAPERS



## UNIVERSITETI I PRISHTINËS Fakulteti i Shkencave të Aplikuara të Biznesit në Pejë në bashkëpunim me

UNIVERSITETI I ZENICËS

dhe

UNIVERSITETI EVROPIAN DUKAGJINI



## ORGANIZON

### KONFERENCËN E PARË SHKENCORE RAJONALE ME PJESËMARRJE NDËRKOMBËTARE me temën

## “Zhvillimi i qëndrueshëm lokal – sfidat dhe mundësitë”

Fushat mbi të cilat kërkohet të hartohen punimet shkencore:

1. Mbështetja dhe zhvillimi i bizneseve nga ana e qeverisë lokale.
  2. Turizmi dhe zhvillimi i qëndrueshëm.
  3. Përmirësimi i sistemeve financuese lokale.
  4. Mbrojtja dhe ruajtja e ambientit në nivelin lokal.
  5. Rregullimi i infrastrukturës lokale si mundësi e mirë në rritjen e investimeve të huaja.
  6. Shfrytëzimi i pronave publike në hapjen dhe zhvillimin e biznesit sportiv.
  7. Menaxhimi i burimeve njerëzore në kuadër të proceseve zhvillimore lokale.
  8. Legjislacioni dhe ndikimi i tij në zhvillimin lokal
  9. Bashkëpunimi ndërkombëtar në nivelin lokal
-

---

### **Sponsorët kryesorë:**

1. Universiteti i Prishtinës
  2. Kuvendi Komunal i Pejës, Gjakovës, Deçanit, Istogut, Klinës dhe Junikut
- 

### **Vendi dhe koha e mbajtjes së konferencës shkencore ndërkombëtare**

Konferenca shkencore ndërkombëtare do të mbahet me datat 03 dhe 04 Qershor të vitit 2011. Organizimi i konferencës shkencore do të bëhet në ambientet e Fakultetit të Shkencave të Aplikuara në Biznes dhe të Universitetit Evropian Dukagjini në Pejë. Të interesuarit për pjesëmarrje mund të shkarkojnë aplikacionin nga ueb faqja zyrtare e fakultetit: [www.fshab.org](http://www.fshab.org) në rubrikën “Aktivitete shkencore”.

### **Kujt i kushtohet kjo konferencë?**

Kjo konferencë i dedikohet procesit zhvillimor të komunave në Kosovë dhe me gjerë duke përfshirë; bizneset, institucionet qeverisë lokale, organizatat kulturore, organizatat sportive, OJQ – të, bashkëpunimin ndërkombëtar, legjislacionin, etj. Përfitimi i tyre nga kjo konferencë është që të shfrytëzohen idetë dhe projektet konkrete që do të kenë ndikim të drejtpërdrejtë në përmirësimin e mundësive të tyre vepruese, me ç'rast nëpërmes këtyre mundësive do të ndikohej në zhvillimin e mirëfilltë lokal.

**Parapakisht ju falënderojmë në interesimin dhe pjesëmarrjen tuaj të mundshme në këtë konferencë.**



### **Objektivat e konferencës**

Objektivat kryesore të kësaj konference janë:

- Shfrytëzimi i ideve të prezantuara që do të kenë ndikim në zhvillimin e fushave të caktuara në nivelin lokal.
- Krijimi i mundësive që të rritet niveli i bashkëpunimit ndërkombëtar në karakterin lokal.
- Ndikimi në rritjen e shkallës së investimeve në Komunë.
- Rritja e numrit të llojit të; bizneseve, shoqërive kulturore, organizatave sportive, etj.
- Transferimi i përvojave nga komunat e ndryshme prej nga edhe vijnë pjesëmarrësit.

#### **Këshilli editorial**

1. Prof. dr. Armand Krasniqi, Dekan në Fakultetin e Shkencave të Aplikuara në Biznes, UP.
2. Prof. dr. Hajredin Kuçi, Profesor në Fakultetin Juridik, UP
3. Prof. dr. Skënder Ahmeti, Dekan në Fakultetin Ekonomik, UP.
4. Prof. dr. Edmond Beqiri, Profesor në Universitetin Evropian – Dukagjini
5. Prof. dr. Arjeta Troshani, Profesoreshë në Universitetin e Shkodrës.
6. Prof. dr. Halid Kurtovic, Profesor në Universitetin e Zenicës .
7. Prof. dr. Bajram Ukaj, Dekan në Fakultetin Juridik, UP.
8. Prof. dr. Berim Ramosaj, Profesor në Fakultetin Ekonomik UP
9. Prof. dr. Baki Koleci, Profesor në Universitetin FON të Shkupit.
10. Prof. dr. Husnjia Bibuljica, Prodekan në Fakultetin e Shkencave të Aplikuara në Biznes, UP.
11. Prof. dr. Mark Bryant, Profesor në Universitetin Evropian – Dukagjini, ish. Prodekan për studentë në Universitetin Belmont (SHBA)
12. Sen.Lect. Eija Vierri Gashi, Ligjeruese e lartë në Universitetin Oulu Finlandë

#### **Vërejtje:**

**Këshilli editorial me kohë do të plotësohet edhe me personalitetet eminente të shkencës.**

#### **Publikimi dhe mënyra e përcjelljes së konferencës**

- Parashihet që përcjellës dhe transmetues të konferencës të jenë mediet lokale dhe ato kombëtare, përdërisa punimet do të publikohen në revistën shkencore e kualifikuar në rangun e publikimeve ndërkombëtare sipas kodit dhe të drejtave që mban Universiteti i Zenicës – Fakulteti Juridik.

- Punimet do të jenë të publikuara së paku një javë përpara konferencës, që nënkupton se me rastin e prezencës së kandidatëve në ditët e mbajtjes së konferencës, atyre do ju dorëzohet revista.
- Parashihet që në kohën e lirë të ketë edhe aktivitete të ndryshme shoqërore përfshirë këtu; vizitën e monumenteve të ndryshme të aspekteve historike dhe kulturore; vizita e bukurive dhe karakteristikave më të rëndësishme të Komunës së Pejës, Kokteje rasti, etj., për të cilat ju do të njoftoheni me kohë;
- Shpenzimet e akomodimit parashihen të jenë të mbuluara përfshirë këtu; fjetjen dhe ushqimin.

#### **Mënyra e aplikimit dhe paraqitjes së punimeve**

- Kërkohet që abstrakti i punimit (maksimum 1 faqe), poashtu edhe punimi (maksimum 10 faqe), të dërgohen më së largu deri me datën e përcaktuar. Të dy dokumentet e lartcekura duhet dërguar në e-mail adresën [revista.fshab@gmail.com](mailto:revista.fshab@gmail.com), ose të dërgohen në formën e shtypur (hardcopy) të bashkëngjitur edhe CD-në, në adresën Rr. e TMK-së, p.n., 30000, Fakulteti i Biznesit, Pejë.
- Gjuha të cilën duhet shkruar punimin është gjuha angleze, përderisa prezantimi mund të bëhet sipas gjuhës amë të çdo kandidati ose sipas dëshirës së tij që ai zgjedh të bëjë prezantimin në gjuhën përkatëse.
- Punimet të cilat nuk mbështeten dhe hartohen në kriteret e përcaktuara, nuk do të merren parasysh. Aplikacioni ose fletëregjistri për pjesëmarrje në konferencë, mund të shkarkohet nga ueb faqja e fakultetit [www.fshab.org](http://www.fshab.org), dhe e plotësuar të dërgohet në e-mail-in ose adresën e fakultetit [revista.fshab@gmail.com](mailto:revista.fshab@gmail.com).
- Nuk janë të parapara pagesat për pjesëmarrje, që nënkupton që aplikimi dhe pjesëmarrja janë pa pagesë.

#### **Data me rëndësi**

1. Dërgimi i abstrakteve..... më së largu deri me 30. 01. 2011
2. Njoftimi për pranimin e abstrakteve..... më së largu deri me 28. 02. 2011
3. Dërgimi i punimeve ..... më së largu deri me 30. 04. 2011
4. Konfirmimi i pranimit të punimeve ..... më së largu deri me 10.05.2011
5. Mbajtja e konferencës shkencore ..... 03.- 04. Qershor 2011